



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosova

REPUBLICA KOSOVA
QENDRA PËR SHËRBIM TË QY.
CENTAR ZA USLUGU GRAĐANA

Sh. 13 Nr. 2218
Û. Br.

Nr. i faq. 5 Data: 28/01
Br. str. Datum: 2025
KAMENICË/A

Komuna e Kamenicës
Opstina Kamenica
Kamenica Municipality



Mbështetur në nenin:12 paragrafi 1 të Rregullores së Ministrisë së Financave të Republikës së Kosovës nr.04/2017, mbi Financimin Publik të OJQ-ve si dhe Rregullores për Kushtet Kriteret dhe Procedurën e Ndarjes së Subvencioneve , me nr. 31251 – 09/2022,
Drejtoria e Kulturës, e Rinisë dhe e Sportit shpallë:

THIRRJE PUBLIKE PËR MBËSHTETJE FINANCIARE PËR PROJEKTE RINORE

Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit - i fton organizatat e regjistruara si **OJQ** (sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi për lirinë e asociimit në organizata jo-qeveritare në Republikën e Kosovës) dhe Individët që kanë përvojë në organizimin e aktiviteteve rinore.

Afati i aplikimit fillon prej datës 29.01.2025 deri më 18.02.2025.

Kategoritë për Aplikim:

1. OJQ-të dhe individët në përputhje me këtë ftesë publike mund të aplikojnë me projektet/programet e tyre që zhvillojnë kapacitetet dhe shkathësitë e të rinjve përmes metodologjisë së edukimit joformal dhe aktiviteteve të tjera të dobishme për zhvillimin individual të të rinjve dhe rritjen e kontributit të tyre në shoqëri;
 - ✦ Organizimi i fushatave vetëdijësuese dhe ndërgjegjësuese për parandalimin e dukurive negative tek të rinjtë.
 - ✦ Organizimi i ngjarjeve të ndryshme në kuadër të manifestimeve tradicionale, përmes aktiviteteve rinore.
 - ✦ Përkrahja e organizatave rinore për realizimin e aktiviteteve rinore dhe fuqizimin rinor.
 - ✦ Përkrahjen e trajnimeve, seminareve, konferencave për edukimin dhe integrimin e rinisë në shoqërinë kosovare dhe ndërkombëtare.
 - ✦ Aktivitete rinore / promovim talentesh / organizim i kampingjeve.
 - ✦ Nxitja e vullnetarizmit dhe pjesëmarrjes aktive të të rinjëve.
 - ✦ Promovimi i diversitetit kulturor, integrimi i grupeve rinore urbane-rurale dhe nga komunitetet e ndryshme etnike.

Kush mund të aplikojë:

- OJQ-të e regjistruara në Republikën e Kosovës që veprojnë në Komunën e Kamenicës të profilizuara në fushën e rinisë, me përvojë të dëshmuar në sektorin përkatës , që plotësojnë kriteret e përgjithshme dhe të veçanta;
- Individët qytetarë të Komunës së Kamenicës, të profilizuar në fushën e rinisë, me përvojë të dëshmuar në sektorin përkatës, që plotësojnë kriteret e përgjithshme dhe të veçanta.

Kriteret e përgjithshme minimale për OJQ-të të përcaktuara me dispozitat në vijim:

- Të jenë të regjistruar si OJQ sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi për lirinë e asociimit në organizata jo-qeveritare në Republikën e Kosovës ;
- Të jenë të pajisur me numër fiskal sipas kërkesave të legjislacionit tatimor të Republikës së Kosovës ;
- Të mos kenë pranuar mjete nga burime tjera të financimit për të njëjtat aktivitete të projekt-propozimit respektiv;
- Të mos ekzistojë ndonjë konflikt interesi në mes të aplikantit, përkatësisht përfaqësuesve/udhëheqësit të aplikantit dhe organizatës buxhetore apo institucionit publik, siç parashihet me legjislacionin në fuqi në Republikën e Kosovës.
- Të ofrojnë dëshmi se OJQ-ja nuk ka obligime tatimore (nga ATK);
- Në rast që OJQ-ja ka përfituar më parë mbështetje financiare publike, duhet të ketë përmbushur detyrimet kontraktuale ndaj ofruesit të mbështetjes financiare;
- OJQ-të nuk kanë të drejtë të aplikojnë me më shumë se 1 projekt-propozim në këtë thirrje publike;
- Anëtarët e OJQ-ve - aplikante nuk kanë të drejtë të aplikojnë edhe si individ në këtë apo ndonjë kategori tjetër në kuadër të kësaj thirrjeje publike.
- OJQ-të që kanë raport negativ të evidentuar nga komisioni i monitorimit, nuk do të kualifikohen për mbështetje.

Kriteret e përgjithshme minimale për INDIVIDËT të përcaktuara me dispozitat në vijim:

- Aktiviteti doemos të realizohet në Komunën e Kamenicës;
- Në rast se individi ka përfituar më parë mbështetje financiare publike, duhet të ketë përmbushur detyrimet kontraktuale ndaj ofruesit të mbështetjes financiare;
- Të mos kenë pranuar mjete nga burime tjera të financimit për të njëjtat aktivitete;
- Të mos ekzistojë ndonjë konflikt interesi në mes të aplikantit, përkatësisht përfaqësuesve/udhëheqësit të aplikantit dhe organizatës buxhetore apo institucionit publik, siç parashihet me legjislacionin në fuqi në Republikën e Kosovës.

- Individët nuk kanë të drejtë të aplikojnë me më shumë se 1 projekt-propozim në këtë thirrje publike.

Periudha e zbatimit të projekt-propozimit:

Projekt-propozimet përfituese në këtë thirrje publike duhet të zbatohen në tërësi deri më 31.12.2025.

Vlerësimi i projekt-propozimeve do të zhvillohet në dy faza:

- 1. Vlerësimi administrativ** - që identifikon nëse aplikanti ka ofruar të gjithë dokumentacionin e nevojshëm në përputhje me kriteret e përgjithshme dhe të veçanta të përcaktuara me këtë thirrje publike për kategoritë përkatëse. Plotësimi i dokumentacionit pas afatit të aplikimit, përkatësisht gjatë periudhës së vlerësimit apo afatit të ankesave, nuk është i mundshëm.
- 2. Vlerësimi përmbajtjesorë** : që vlerëson nëse:

Me rastin e vlerësimit të projekt-propozimeve, Komisioni do të vlerësojë me sa vijon:

- Aplikanti është i profilizuar në fushën e rinisë ;
- Aplikanti ka aplikuar parimet e qeverisjes së mirë në zbatimin e programit respektiv në vitet paraprake;
- Aplikanti ka paraparë zbatimin e parimeve të qeverisjes së mirë në zbatimin e projekt-propozimit të prezantuar në këtë thirrje publike;
- Aplikanti posedon kapacitete profesionale dhe teknike për të zbatuar aktivitetet e planifikuara të projekt-propozimit;
- Është përcaktuar ekipi i projekt-propozimit dhe detyrimet e anëtarëve të ekipit;
- Projekt-propozimi përputhet me fushëveprimin e kësaj thirrjeje publike;
- Projekt-propozimi kontribuon në përmbushjen e objektivave të përcaktuara me këtë thirrje publike për kategoritë përkatëse;
- Aktivitetet e projekt-propozimit janë të qarta, të arsyeshme, të kuptueshme dhe të zbatueshme;
- Kostot e projekt-propozimit janë reale karshi rezultateve specifike dhe kohëzgjatjes së pritshme të projekt-propozimit;
- Kostot e projekt-propozimit janë në përputhje me aktivitetet e planifikuara të projekt-propozimit.

- 2. Vlera totale financiare e planifikuar e thirrjes publike është: 10,000.00 euro,**

Shkalla e mbështetjes për OJQ

- Shuma maksimale e mbështetjes për përfituesit: 5,000.00 Euro
- Shuma minimale e mbështetjes për përfituesit: 550.00 Euro

Shkalla e mbështetjes për individ

- Shuma maksimale e mbështetjes për përfituesit: 1,500.00 Euro
- Shuma minimale e mbështetjes për përfituesit: 550.00 Euro

OJQ-të mund të aplikojnë me më së shumti një (1) projekt në kuadër të kësaj ftese publike.

Propozimet do të dorëzohen vetëm në formularët e paraparë të cilat së bashku me Udhëzimet për aplikantë janë në dispozicion në faqen e internetit të ofruesit të mbështetjes <https://kk.rks-gov.net/kamenicë>

Dokumentet e kompletuara duhet të dorëzohen personalisht në adresën e më poshtme:

KOMUNA E KAMENICËS

Rr. "Skënderbeu"

Objekti i Administratës Komunale

Qendra për Shërbim me Qytetarë

Procesi i pranimit hapjes dhe shqyrtimit të aplikacioneve përfshinë,

- Vlerësimi i aplikacioneve;
- Kontraktimi;
- Dhënia e fondeve;
- Koha dhe mënyra e parashtrimit të ankesave.

Do të konsiderohen për mbështetje vetëm projektet që janë pranuar brenda afatit të paraparë me këtë thirrje publike dhe të cilat i përmbushin plotësisht kushtet e përcaktuara të thirrjes publike.

Më shumë informacione rreth thirrjes publike:

Të gjitha çështjet që lidhen me ftesën publike mund të sqarohen te zyrtari përgjegjës **Ardian Berisha** , në mënyrë elektronike duke dërguar e-mail në adresën: ardian.berisha11@gmail.com , ose në numrin kontaktues +383(0)49 317 350 gjatë orarit të punës 08:00-16:00h (e hënë – e premtë).

